# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-444764**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kontratat 1 euro, hapet rruga për blerjen e pronës |
| ADRESA | `https://lapsi.al/kontratat-1-euro-hapet-rruga-per-blerjen-e-prones-i1093722` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 05:45:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 05:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3676a56bc264e830df7993eb912bd6dad10aa32298f91e98cc6afc9a3b132437` |
| TEKSTI | `585a2861c354962d290a54e03f6593ecee150c1cb096db0c39ec242df6a9b534` |
| PAMJA | `8f5960a49de5798acd5f73aeda0bda671f53473a470ec0145ccc85511eef1999` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `104d274aaec4c9322915c0674d26ceeb8de1481e392fbb526ec1f41467530b79` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `07dcd14af433ca62f57d8764b5c6075704d5b7e87042b539795708e53d505cef` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/104d274aaec4c9322915c0674d26ceeb8de1481e392fbb526ec1f41467530b79`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Kontratat 1 euro, hapet rruga për blerjen e pronës

LAPSI.AL • 15 SEPTEMBER 2026



Qeveria ka ndryshuar rregullat për përdorimin dhe privatizimin e pronave shtetërore, duke përcaktuar kushtet kur subjektet me kontrata me tarifën simbolike 1 euro mund të kërkojnë blerjen e pasurisë, si dhe sanksionet kur nuk realizohen investimet ose vendet e punës të marra përsipër.

Ndryshimet janë bërë përmes dy udhëzimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, nr. 6 dhe nr. 7, të datës 1 shtator 2026. Udhëzimi nr. 6 rregullon dhënien me qira dhe enfiteozë të pasurive shtetërore, ndërsa udhëzimi nr. 7 ndryshon procedurat për vlerësimin, privatizimin dhe shitjen e tyre.

Sipas udhëzimit nr. 7, subjektet që kanë marrë prona shtetërore me sipërfaqe mbi 500 metra katrorë me kontrata qiraje ose enfiteoze me tarifën "1 euro/kontrata" mund të kërkojnë blerjen e tyre, me kusht që prona të mos jetë e patjetërsueshme.

Për t'u shqyrtuar kërkesa, subjekti duhet të ketë realizuar brenda afatit kontraktor "investime në vlerë mbi 5,000,000 euro dhe në një vlerë më të lartë se 750 për qind e vlerës së pasurisë shtetërore objekt i kërkesës për blerje". Përmbushja e këtyre kushteve duhet të vërtetohet me dokumentacion kontraktor, financiar dhe teknik.

Po sipas udhëzimit nr. 7, blerja e pronës nuk e çliron subjektin nga detyrimi për të realizuar investimin e plotë të parashikuar në planin e biznesit dhe në kontratën e mëparshme të qirasë ose enfiteozës. Ky detyrim duhet të përfshihet në kontratën e shitjes dhe të pasqyrohet si kufizim në kartelën e pasurisë.

Nëse investitori nuk e përmbush këtë detyrim, udhëzimi i jep Ministrisë së Ekonomisë të drejtën të zgjidhë kontratën e shitjes në mënyrë të njëanshme.

"Ministria përgjegjëse ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e

ide


Ortaku bespreré i Ron Yeffetit
Andi Bushati


Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeminstri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTI TIRANA 19°C
KËMBIMI EURO 91.80

aktuale

20:58
Dhuna policore/ Protestuesit paralajmërojnë përshkallëzim: Do bllokojmë institucionet

08:10

Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku



shitjes [...] me rikthimin e pasurisë së privatizuar në pronësi të shtetit dhe me të drejtën për të mbajtur shumën e paguar më parë nga blerësi për blerjen e pasurisë", përcakton udhëzimi nr. 7.

Blerësi gjithashtu nuk mund t'ia tjetërsojë pronën një pale të tretë deri në realizimin e plotë të investimit. Udhëzimi përcakton se ky ndalim "përbën hipotekë ligjore mbi pasurinë" dhe pasqyrohet në regjistrin kadastral.

Ndërkohë, udhëzimi nr. 6 vendos rregulla të veçanta për zbatimin dhe monitorimin e kontratave me tarifën simbolike 1 euro.

Për mosrealizimin e investimit të përcaktuar në kontratë, "subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës penalizohet me 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar", sipas udhëzimit nr. 6.

I njëjti udhëzim vendos edhe një penalitet për mosrealizimin e punësimit të premtuar. "Për çdo vend pune të parealizuar [...] subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës penalizohet me 50,000 lekë". Numri i vendeve të punës përcaktohet mbi bazën e mesatares vjetore të punonjësve të deklaruar pranë administratës tatimore.

Udhëzimi nr. 6 kërkon që investimet e realizuara të kontrollohen përmes raportit të audituesit ligjor dhe ekspertit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, bilancit financiar dhe aktit të përbashkët të monitorimit. Kur investimi rezulton në nivelin e përcaktuar në kontratë, miratohet kthimi i garancisë së ngurtësuar.

Po ky udhëzim ndryshon edhe mënyrën e zhvillimit të procedurave për dhënien me qira ose enfiteozë të pronave shtetërore. Pas publikimit të konkurrimit, "komunikimi ndërmjet institucionit dhe ofertuesve, administrimi i dokumentacionit dhe çdo veprim procedural gjatë konkurrimit zhvillohen vetëm nëpërmjet adresës zyrtare elektronike të institucionit".

Udhëzimi nr. 6 përcakton gjithashtu mënyrën e llogaritjes së tarifës dysheme për pronat shtetërore. Për ndërtesat, tarifa mujore minimale për metër katror është 0.3% e vlerës mesatare të shitblerjes së banesave në bashkinë ku ndodhet prona. Në shembullin e dhënë në udhëzim për një ndërtesë 100 metra katrorë në Tiranë, detyrimi minimal llogaritet në 37,295 lekë në muaj.

Monitorimi i kontratave, sipas udhëzimit nr. 6, përfshin pagesën e qirasë, kamatëvonesat dhe penalitetet, realizimin e investimeve dhe nivelin e punësimit. Njësia përgjegjëse duhet të hartojë aktet e përbashkëta të monitorimit të paktën një herë në gjashtë muaj./Monitor

## Të këshilluara



### Kthjellime dhe vranësira, parashikimi i motit për sot

Dita e martë pritet të sjellë kushte atmosferike relativisht të paqëndrueshme në vendin tonë. Moti parashikohet me alternime...



### Nafta në Shqipëri kushton 2.6 herë më shumë se mesatarja e gjithë Europës, ndaj fuqisë blerëse

Nafta në Shqipëri është ndër më të shtrenjtat në Europë, por për konsumatorin shqiptar kostoja reale ësh...





**Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"**



Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën e tmerrshme në Pediatrinë e QSUT-së



Plagosi me çekiç ish-vjehrrin, shpallet në kërkim daja i deputetes Zegjine Çaushi



Berisha: Ka tension mes Ramës dhe Ballukut, shkak arrestimi i Gys Agasit




## Pacolli publikon letrën që i ka dërguar Karakaçit: Na lejoni të përfundojmë aeroportin e Vlorës



### Greqia kërkon heqjen e imunitetit të eurodeputetit socialist Nikos Papandreu

Autoritetet greke i kanë kërkuar Parlamentit Evropian heqjen e imunitetit nga ndjekja penale të eurodeputetit socialist të PASOK-ut, Nikos ...



### Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht ç'mund të ndodhë këtë javë në Kosovë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se përkushtimi i Aleancës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë...



### Vuçiç njofton dorëheqjen: Largohem më 27 shtator!

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka njoftuar se do të japë dorëheqjen nga posti më 27 shtator. Ai tha se gjat&eum...




## Del një tjetër PERGJIM i Ron Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua



### I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA

Vizita në FSHF e të dërguarit special të presidentit Trump në Tiranë, Paolo Zampolli duket se lidhet me një përpjekje lobimi për rizgjedhjen e



Gianni Infantino në krye të FIFA, edhe pasi Shqipëria tërhoqi zyrtarisht mbështetjen për të.




### 107 ditë rezistencë, protestuesit kërkojnë dorëheqjen e Ramës

Ka nisur protesta e 107 kundër qeverisë ku kërkohet dorëheqja e kryeministrit Edi Rama. Protestuesit janë mbledhur fillimisht në ...



### Dhuna policore/ Protestuesit paralajmërojnë përshkallëzim: Do bllokojmë institucionet

Dhuna e pretenduar policore gjatë protestës së 107-të kundër qeverisë së Edi Ramës ka sjellë reagimin e protestues...

## Me sytë katër



20:36

### PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

Një denoncim është publikuar së fundmi nga një qytetar shqiptar, i cili ndodhej në avionin me të cilin Edi Rama ka mbër...



Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43



PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17



A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

16:47



"Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56

## SPORT

→ Të tjerë artikuj




23:04

### Gafë tjetër e portierit, por Inter është i frikshëm: nën dy gola dërrmon Udinesen 5-3, Roma e Como e ndjekin



19:53

Jo më me Brazilin është një vendim i Neymar, Ancelotti: "Nuk dëshiron të rikthehet në kombëtare"



19:41

"Adzic nuk donte t'i shënonte Juves": teoria e komplotit evidenton hezitimin e lojtarit të huazuar te Sassuolo













Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.